

community

The New Apostolic Church around the world

03/2022/AI



Të bashkuar me dhe në Krishtin

Kryeartikulli

Të zgjedhur për të shërbyer

Shërbesa fetare

Të bashkuar me dhe në
Krishtin

Teoria kishtare

Midis ndihmës që jepet
gjatë procesit të vdekjes
dhe mjekësisë paliative

New Apostolic Church
International



■ Kryeartikulli

- 3 Të zgjedhur për të shërbyer

■ Shërbesa fetare

- 4 Të bashkuar me dhe në Krishtin

■ Këndi i fëmijëve

- 10 Kaini nuk e dëgjo Perëndinë
12 Për vizitë tek Aubrey in Palatine (USA)

■ Doktrina

- 14 Midis ndihmës që jepet gjatë procesit të vdekjes dhe mjekësisë paliative

■ Lajme globale

- 18 „Ne ecim me ritmin tonë“

Të zgjedhur për të shërbyer

Të dashur bashkëbesimtarët e mi,

unë jam marrë shumë me temën e “të qenurit i zgjedhur”. Ne jemi ende të prirur të mendojmë se jemi zgjedhur vetëm për t’u shpëtuar në fund të kohës. Zoti na zgjodhi, ne do të shpëtojmë dhe të gjithë të tjerët jo.

Por nuk është aq e lehtë. Një shembull i thjeshtë: Ne të gjithë njohim bashkëbesimtarë apo edhe anëtarë të familjes që nuk janë më të interesuar për Zotin, nuk ndjekin më shërbesat e kishës, nuk kanë më marrëdhënie me Perëndinë. A mund të themi për ta me të vërtetë se nuk janë të zgjedhur, se do të humbasin? Kushdo që ka në vete një shkëndijë dashurie për tjetrin, nuk mund të mendojë kështu. Ky nuk mund të jetë kuptimi i të zgjedhurit tonë.

Por atëherë çfarë është “zgjedhja”? Zgjedhje do të thotë të thirresh në një post, për të shërbyer. Ti je zgjedhur për t’i shërbyer Zotit dhe për të ndihmuar e kontribuar në shpalljen e shpëtimit të Tij për të gjithë njerëzit. Kjo është zgjedhja. Kjo mund të duket më pak e rehatshme, por mund të arrihet vetëm me dashurinë që mund të kesh për tjetrin.



Foto: NAK International

Ti nuk je zgjedhur për t’u shpëtuar dhe të gjithë të tjerët për të humbur; ti je thirrur për t’i shërbyer Zotit dhe njerëzve të tjerë. Kjo është zgjedhja: zgjedhje për shërbim!

Të fala të sinqerta, juaji



Jean-Luc Schneider

Të bashkuar me dhe në Krishtin



Edhe pse vetëm rreth 230 bashkëbesimtarë qenë prezent në kishë gjatë shërbesës në Calgary (Kanada), më shumë se 13,500 pjesëmarrës ishin gjithashtu të lidhur nëpërmjet internetit me këtë shërbesë

Photos: NAC Canada



1. Gjoni 1,3

*Atë që pamë dhe dëgjuam,
jua shpallim edhe juve, që edhe
ju të keni shoqëri me ne;
dhe bashkësia jonë është me Atin
dhe me Birin e tij Jezu Krishtin.*

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, mendoj se shumë prej nesh i janë mirënjohës Atit tonë Qiellor që bëri të mundur ta festojmë dhe ta përjetojmë këtë shërbesë fetare së bashku këtu në Calgary; dhe që kaq shumë vëllezër dhe motra në Amerikën e Veriut mundën të bashkohen me ne. Ne i jemi mirënjohës atij që dëgjoji lutjet tona dhe që bëri të mundur të mblidhemi për të marrë mesazhin e Perëndisë, i cili ndërmjetësohet nga Fryma e Shenjtë.

Mesazhi i parë i Frymës së Shenjtë është: Askush nuk harrohet nga Zoti! Unë veçanërisht dua t'ua drejtoj këtë mesazh atyre që janë në nevojë dhe ankth. Ka shumë prej tyre. Gjithshka rrotullohet rreth Covid-it tani. Por në njëjtën kohë, jeta e përditshme vazhdon. Shumë vëllezër dhe motra duhet të jetojnë me sëmundje, të tjerë vajtojnë, të tjerë duhet të luftojnë me problemet në vendin e punës, në familje, në një partneritet ose kanë probleme financiare.

Ndoshta atëherë vjen mendimi se jemi harruar sepse gjithçka rrotullohet rreth Covid-it. Askush nuk harrohet nga Zoti. Ai i di mendimet tuaja; ai e di problemin tuaj; ai ndan dhimbjen tuaj, besojini atij! Ai do të ndihmojë.

Por do të doja t'ua drejtoja këtë mesazh edhe atyre që janë në jetë nga ana e diellit; që përjetojnë shumë gjëra të bukura; që janë thjesht të lumtur; që përjetojnë bekimin dhe praninë e Zotit. Ndoshta ata i vret ndërgegje sepse po jetojnë shumë mirë. Ju nuk duhet të shqetësoheni për këtë! Jezusi ndan gëzimin tuaj. Shijoni bekimet që Zoti ju ka dhuruar dhe falënderoni Atë në mënyrën e duhur! Askush nuk harrohet nga Ati ynë Qiellor.

Edhe në këtë kohë të vështirë e shumë të veçantë, asgjë nuk ka ndryshuar për ne në prioritetet tona, në qendër të jetës sonë. Ne duam të përgatitemi për kthimin e Krishtit. Kjo është arsyeja pse ne jemi këtu sot. Kjo është arsyeja pse ne besojmë në Krishtin. Ne duam shoqëri të përjetshme me Perëndinë. Ne duam të marrim pjesë në bashkësinë e Perëndisë, Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë. Ne duam të jetojmë së bashku me Krishtin në mbretërinë e tij në përjetësi. Ky është *raison d'être*, kuptimi i besimit të krishterë. Nuk ka të bëjë me të qenit i lumtur në tokë, të jesh i suksesshëm, të mos kesh probleme, të bëhesh i pasur apo çfarëdo tjetër. Një i krishterë ka një dëshirë të madhe që të ketë shoqëri të përjetshme me Krishtin. Përndryshe Krishti do të kishte vdekur më kot. Ne duam shoqërim me Perëndinë në mbretërinë e Tij. Ne duam të marrim pjesë në bashkësinë e Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Kjo është arsyeja pse ne kemi këtë moto, "Së bashku në Krishtin". Ky është hapi tjetër në planin e shpëtimit.

Këtu autori i letrës së parë të Gjonit thotë se njeriu mund të ketë shoqëri me Perëndinë vetëm nëse ka shoqëri me apostujt. Ka një arsye për këtë: në atë kohë, pas disa dekadash në kishën e hershme, kishte pikëpamje të ndryshme për personin dhe natyrën e Jezu Krishtit. Disa kishin këtë ide, të tjerët atë. U kuptua se kështu nuk mund të ecej.. Prandaj autori thotë këtu në këtë letër se kushdo që do të kishte shoqëri me Jezu Krishtin, duhet të ketë shoqëri me apostulatin; ai duhet të besojë në mësimet e apostujve; të cilët duhet të besojnë në dëshmitë e atyre që e panë dhe dëgjuan Jezu Krishtin kur ai ishte në tokë.

Pra, nuk ka të bëjë me mësimin e Apostujve apostolikë të rinj. Ne flasim për mësimin e apostujve sipas transmetimit të Biblës. Është dëshmia e atyre që panë dhe dëgjuan Jezu Krishtin kur Ai ishte në tokë; të caktuar për t'u mësuar të

tjerëve atë që u mësoi Jezusi vetë atyre. Njeriu nuk mund të ketë bashkësi me Krishtin nëse nuk beson në mësimin, në dëshminë e apostujve siç është shkruar në Dhiatën e Re.

Jezu Krishti paralajmëroi se do të kishte shumë njerëz që do të thoshin: "Vini re, këtu është Krishti; ja shikoni, atje është Krishti!" (Marku 13,21). Ai tregoi për njerëzit që do të thonë se janë dërguar nga Krishti; që kryejnë mrekulli të mëdha duke profetizuar për Krishtin; që dëbojnë demonët - dhe që janë shumë të suksesshëm. Jezusi paralajmëroi për kujdes, duke thënë se jo të gjitha këto do të dërgohen në të vërtetë prej tij (krh. Mk 13,21-23; Mt 7,22,23).

Nuk është detyrë e Kishës Apostolike të Re të kategorizojë kishat e ndryshme dhe të thotë se cila është një kishë e mirë dhe cila është një kishë e keqe. Kjo nuk është puna jonë. Detyra e apostulit sot është të shpallë mësimin e Jezu Krishtit siç është transmetuar nga apostujt në Shkrimin e Shenjtë. Secili mund të bëjë dhe të predikojë çfarë të dojë, por detyra jonë është të përgatitemi për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë, për të pasur shoqërim me Krishtin. Për ta bërë këtë, ne duhet të

besojmë në mësimet e apostujve, në dëshminë e atyre që ishin me të në tokë. çfare thane ata, çfarë raportuan ata? Çfarë tha Jezusi për veten e tij? Më lejoni të rendis pesë pika:

Pika e parë: Jezusi tha se i gjithë Shkrimi – pra për ne sot Dhiata e Vjetër – flet për të (krh. Gjn 5,39; Lk 24,44). Në sytë e Jezusit, Dhiata e Vjetër paralajmëroi ardhjen e tij. Kjo do të thotë se është pjesë e mësimin të apostujve se Dhiata e Vjetër duhet kuptuar dhe interpretuar duke filluar nga Jezu Krishti. Ajo që është e rëndësishme për shpëtimin tonë në Dhiatën e Vjetër është ajo që ka të bëjë me Jezu Krishtin. Ju nuk mund të merrni thjesht një fjali nga një fragment i Dhiatës së Vjetër dhe të thoni: "Kjo është për ne sot." Ajo që është e rëndësishme për ne, për shpëtimin tonë, në Dhiatën e Vjetër duhet kuptuar duke u bazuar në dritën e Ungjillit, në bazën e fjalëve dhe veprave të Jezu Krishtit. Kjo është diçka shumë e rëndësishme!

Jezu Krishti tha gjithashtu se Ai nuk erdhi, nuk u dërgua nga Ati për të ndëshkuar mëkatarët. Përkundrazi, Ai u dërgua për të shpëtuar mëkatarët! Gjon Pagëzori e keqkuptoi këtë; po ashtu edhe dishepujt. Ata menduan se duhej të ndëshkonin. Mendoni për Pjetrin: Ai donte të ndëshkonte dhe t'i priste veshin shërbëtorit të kryepërfittit që donte të arrestonte Jezusin. Jezusi nuk pranoi (krh. Lk 22,49-51). Një herë tjetër dishepujt donin të dërgonin zjarr nga qielli

Askush nuk harrohet nga Ati ynë Qiellor.

për të ndëshkuar mëkatarët. Ai gjithashtu e hodhi poshtë këtë gjë (krh. Lk 9,51-56). Ai nuk erdhi për të ndëshkuar mëkatarët, por për t'i shpëtuar ata. Mësimi i apostujve na thotë se asnjë njeri nuk është dërguar nga Jezu Krishti për të ndëshkuar mëkatarët në emrin e tij. Askush nuk mund ta thotë këtë për veten e tij. Jezu Krishti është Shpëtimtari. Sigurisht që shoqëria duhet të vendosë rregulla dhe të ndëshkojë kriminelët. Jezusi nuk e kundërshtoi këtë. Ai respektonte normat shoqërore të kohës së tij. Por nuk duhet ndëshkuar askush në emër dhe për llogari të Jezu Krishtit. Ky nuk është mësimi i tij.

Jezusi tha gjithashtu se mbretëria e tij nuk është e kësaj bote (krh. Gjn 18,36). Ai donte të shprehej se nuk erdhi në tokë për të zgjidhur të gjitha problemet tokësore të njerëzve; se ai nuk kishte ardhur për të qenë mbret i tyre, për të sunduar vendin e tyre. Populli hebre ishte i zhgënjyer sepse prisnin që ai t'i çlironte nga romakët dhe të zgjidhte të gjitha problemet e tyre. Ata donin që ai të pasuronte të varfërit dhe të shëronte të sëmurët. Jezusi nuk pranoi. Mbretëria e tij nuk është e kësaj bote, ai nuk erdhi për të krijuar një katalog të ri mëkatesh dhe rregullash. Ai vetëm tha: "Duaje Perëndinë dhe duaje të afërmin tënd" (krh. Lk 10,27).

Ai nuk u pajtua me farisenjtë dhe listën e tyre të gjatë të rregullave dhe ligjeve. Jezusi nuk erdhi për të sunduar botën. Ungjilli nuk është një listë zgjidhjesh për problemet tokësore të njerëzve. Nëse kemi probleme, kjo ndodh sepse bota është nën sundimin e së keqes. Askush nuk mund ta zgjidhë këtë problem. Ka vetëm një Shpëtimtar dhe ai është Jezu Krishti. Ai dëshiron ta zgjidhë këtë problem duke na çliruar nga e keqja. Ai dëshiron të na çojë në mbretërinë e tij, më vonë në krijimin e ri, ku nuk do të ketë më vend për të keqen, vuajtjen dhe vdekjen. Kjo është zgjidhja e Jezu Krishtit. Ai na tregon se çfarë duhet të bëjmë që të shpëtohem dhe të hyjmë në mbretërinë e tij, ku telashet nuk do të ekzistojnë më dhe e keqja nuk do të ekzistojë më. Ky është mësimi i Jezu Krishtit.

Eshtë gjithashtu mësimi i Krishtit që Biri i Perëndisë erdhi në tokë, u bë një njeri i vërtetë dhe si i tillë mundi të keqen dhe vdekjen. Me këtë ai ka fituar një meritë të madhe që askush tjetër nuk mund ta fitojë; sepse ai ka bërë atë që askush tjetër nuk mundi ta bëjë. Ai e mundi njëqind për qind të keqen dhe vdekjen (krh. Fil 2,5-8). Dhe ai dëshiron të ndajë me ne meritat e tij; ai dëshiron të ndajë fitoren e tij me ne, sepse ai e di se ne nuk mund ta bëjmë atë vetëm.

Thjesht duhet të besojmë në të, t'i besojmë dhe të jemi në shoqëri me të. Pali shton se ne duhet të ndajmë vuajtjet e tij (krh. Fil 3,10). Jezusi nuk erdhi në tokë për të na shpëtuar nga të gjitha problemet; ai dëshiron që ne të qëndrojmë të palëkundur dhe besnikë në tundime; ai dëshiron që ne të jemi në shoqëri me të në vuajtje.

Kjo do të thotë, kur ne vuajmë, ne duhet ta bëjmë atë në të njëjtën mënyrë siç vuajti Ai. Edhe në vuajtje duhet ta duam Zotin, t'i besojmë atij, të jemi të bindur dhe besnikë deri në fund. Kjo është bashkësia në vuajtjen e tij. Ky është mësimi i Jezu Krishtit.

Pika e fundit që do të doja të numëroja: Ai tha se çfarë duhet të bëjmë për të hyrë në mbretërinë e tij - dhe kjo nuk është një shpikje e Kishës Apostolike të Re. Ai tha se duhet rilindur nga uji dhe nga Fryma e Shenjtë për të hyrë në mbretërinë e tij (krh. Gjn 3,3). Njeriu duhet të marrë jetën e Perëndisë në mënyrë që të ketë bashkim me Perëndinë, Atin, Birin dhe Frymën e Shenjtë.

Ai tha gjithashtu se kushdo që dëshiron të ketë jetë të përjetshme, duhet të hajë mishin e tij dhe të pijë gjakun e tij (krh. Gjn 6,54-56). Pra, ne duhet të festojmë Darkën e Shenjtë. Ata që dëshirojnë të fitojnë jetën e përjetshme duhet të marrin shenjtërimet! Të dashur vëllezër dhe motra, kjo është një përmbledhje e shkurtër e mësimëve të apostujve. Dhiata e Vjetër është e rëndësishme sa herë që ne e lidhim atë me mësimet e Jezu Krishtit dhe e kuptojmë atë në bazë të fjalëve dhe veprave të tij. Jezu Krishti nuk erdhi për të ndëshkuar, por për të shpëtuar. Ai nuk erdhi për të zgjidhur të gjitha problemet tokësore dhe për të sunduar mbi shoqërinë. Ai erdhi për të na çliruar nga e keqja dhe për të na çuar në mbretërinë e tij. Ai triumfoi mbi të keqen dhe dëshiron të ndajë fitoren e tij me ne. Gjithçka që duhet të bëjmë është t'i besojmë atij, të ndajmë dashurinë e tij, të besojmë në të dhe t'i qëndrojmë besnikë edhe kur vuajmë; dhe ne duhet të marrim shenjtërimet.

1 Gjoni vazhdon duke thënë se ata që dëshirojnë të kenë shoqëri me Jezu Krishtin dhe Atin duhet të kenë shoqëri me njëri-tjetrin. Njeriu nuk mund të ketë shoqëri me Zotin, nuk mund ta dojë Zotin, nëse nuk e do njëri-tjetrin. Kjo është e lidhur pazgjidhshmërisht. Nëse duam të jemi me Krishtin, atëherë duhet të jemi bashkë në Krishtin. Jezusi e bëri shumë të qartë këtë. Ai shprehu solidaritetin e tij me të gjithë besimtarët kur tha: "Çfarëdo që i bërë njërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, ma bëre mua" (Mt 25,40).

*Jezusi fitoi mbi
të keqen dhe
dëshiron ta ndajë
me ne këtë fitore.*



Here pas herë një kor i gëzoi pjesëmarrësit

Në mënyrë që të kemi shoqëri me Jezu Krishtin, ne duhet të ndajmë ndjenjat, mendimet e tij. Biri i Perëndisë - Ai është Perëndia - jetoi në lavdinë e Perëndisë në qiell, ku gjithçka është e përsosur, e shenjtë dhe e mrekullueshme. Ai e la këtë lavdi për të ardhur në tokë dhe për të ndarë kushtet e jetesës së njerëzve. Ai ndau gëzimin e tyre, pikëllimin, dhe mori utesë në jetën e tyre. Ai madje pranoi vdekjen sepse edhe njerëzit duhet të vdesin. Ai la lavdinë e Tij për të qenë ne ata që jemi - qenie njerëzore -, për të treguar solidaritetin e Tij dhe vetëm për të na shpëtuar. Çfarë ndodh kur e kemi këtë dashuri të Jezu Krishtit në zemrat tona? Ne interesohemi për gjendjen e të afërmit tonë. Ne jemi gati të largohemi nga zona jonë e rehatisë dhe të ndihmojmë kur shohim se fqinji ynë po vuan, se ai ka nevojë për diçka. Kjo nuk është e lehtë. Është më e lehtë të injorosh atë që vuan. Shpesh më duket se vuajtja është ngjitëse; sepse sapo dikush është i pakënaqur, të tjerët bëjnë gjithçka që mundën për t'iu shmangur. Por kjo nuk është ngjitëse! Le të lëmë zonën tonë të rehatisë për të qëndruar pranë fqinjit tonë, për të ndarë dhimbjen dhe vuajtjen e tij, për ta ngushëlluar dhe për ta ndihmuar. Kërkesa e madhe e Jezusit për nxënësit e tij ishte, që ata të ishin një, pasi Ati dhe ai janë një (krh. Gjn 17,20,21). Jezusi e dinte se nuk është e mundur të ndahesh në bashkësinë e Atit dhe të Birit pa shoqërinë me njëri-tjetrin mes dishepujve të Tij. Ai i nxiti ata të ndihmonin njëri-tjetrin – “Atë që i bëni atij, ma bëni mua.” Pra, përsëri, nëse duam të kemi shoqëri me Krishtin, duhet të kemi shoqëri me njëri-tjetrin në Krishtin!

Për të na ndihmuar, për të na mundësuar të kemi shoqëri me Perëndinë dhe shoqëri me njëri-tjetrin, Zoti dërgoi

apostujt. Nëpërmjet apostulatit ne marrim gjithçka që na nevojitet për t'u bërë një me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin. Nuk bëhet fjalë për personin, por për postin! Gjëja e parë që na ndihmon të bëhemi një është mësimi i apostujve - dhe tani flas për apostujt që jetojnë sot. Jam shumë mirënjohës që në Kishën Apostolike të Re kemi një teori, një doktrinë. Ne kemi një besim të përbashkët, një dëshmi të besimit, një katekizëm. Sa e trishtueshme do të ishte nëse, përpara se të dëgjonim një apostul, do të na duhej të shqyrtonim se në anën e kujt është ai, çfarë interpretimi të Shkrimit dhe Ungjillit po ndjek! Është kaq e thjeshtë në kishën tonë. Ne kemi një besim, një doktrinë, një mjeshtëri, një katekizëm dhe një qëllim. Kur jemi një me mësimet e apostujve, është e lehtë të jemi një me njëri-tjetrin. Kur çdo predikues dhe çdo besimtar ka interpretimin e vet të Shkrimit, uniteti bëhet i pamundur. Aty ku Fryma e Shenjtë është në veprim, ajo punon për unitet.

Apostujt na shpallin edhe faljen e mëkateve. Kur apostuli ose prifti i ngarkuar prej tij shpall: "Mëkatet e tua të janë falur", atëherë mund të jemi të sigurt për hirin e Jezusit. Pa falje, ne si mëkatarë, nuk mund të kemi shoqëri me Perëndinë, nuk mund të hyjmë në mbretërinë e tij. Ne duhet të pastrohemi nëpërmjet faljes së mëkateve tona.

Nëpërmjet Apostujve ne marrim sakramentet e Pagëzimit të Shenjtë dhe Vulës së Shenjtë dhe bashkë me to jetën hyjnore. Si mund të kishim shoqëri me Perëndinë nëse nuk kishim jetë hyjnore brenda nesh? Krijesa e re në Jezu Krishtin - vetëm kjo është në gjendje të hyjë në mbretërinë e Perëndisë. Ne duhet të bëhemi një krijesë e re që të kemi

bashkësi të përjetshme me Perëndinë dhe kjo dhurohet nëpërmjet apostujve të dërguar nga Jezu Krishti - "Pagëzoji ata" (Mt 28,19)! Nëpërmjet apostujve në marrim dhuntinë e Frymës së Shenjtë.

Pika e fundit: Aty ku Fryma e Shenjtë vepron nëpërmjet apostulatit, ne mund të festojmë Darkën e Shenjtë dhe të marrim në të atë që është e nevojshme për shpëtimin tonë - trupin dhe gjakun e Jezu Krishtit. Mos harroni: "Nëse nuk e hani mishin tim...". Nëpërmjet apostolatit në marrim trupin dhe gjakun e Jezu Krishtit. Kur bashkësia feston Darkën e Shenjtë, trupi dhe gjaku i Jezusit janë të pranishëm. Jezusi nuk është i pranishëm vetëm në shpirt ose në kujtesën tonë. Jo, ai është vërtet i pranishëm me mish e gjak. Nuk është thjesht një ide, nuk është thjesht një koncept apo frymëzim. Jo, kur festojmë Darkën e Shenjtë me apostujt, mund të jemi të sigurt se Jezusi është i pranishëm me mish e gjak në atë moment. Ai është me të vërtetë atje, ai është me ne, ai është në anën tonë. Mund të themi: Ai nuk është më në mbretërinë e të vdekurve, ai është i gjallë dhe ai është këtu.

Çfarë ndodh kur ai është i pranishëm? Çfarë ndodhi kur Jezusi ishte me dishepujt e tij? Ai nuk i lejoi ata të gjykojnë të tjerët. Kjo nuk ishte puna e tij. Nuk i lejoi të grinden me njëri-tjetrin. Shumë probleme u zgjidhën vetëm sepse Jezusi ishte atje. Kur festojmë Darkën e Shenjtë, Jezusi është aty. Nëpërmjet tij, nëpërmjet mishit dhe gjakut të tij, ne marrim natyrën e tij. Ai ushqen krijesën e re dhe ne mund të rritemi për t'u përgatitur për hyrjen në mbretërinë e Perëndisë.

Darka e Shenjtë gjithashtu na ndihmon të kemi bashkësi me njëri-tjetrin në Krishtin. Bibla thotë se ne jemi një trup i vetëm, sepse të gjithë marrim të njëjtën bukë (krh. 1 Kor 10,17). Kur marrim Darkën e Shenjtë, mund të shohim se të gjithë marrim të njëjtën bukë. Kjo bukë është fjala, mësimi i Jezu Krishtit, nga njëra anë, dhe trupi dhe gjaku i Jezusit nga ana tjetër. Dhe ne të gjithë marrim të njëjtën gjë. E gjithë kisha mund të shohë se çdo fëmijë i Perëndisë, çdo besimtar, merr të njëjtën doktrinë dhe shenjtërim – dhe se ajo zbatohet për të gjithë, pavarësisht nga personi dhe situata në të cilën gjenden. Në fakt, situatat individuale të jetës brenda bashkësisë mund të jenë shumë të ndryshme; por kur festojmë Darkën e Zotit mund të shohim se ka një bukë. Qëllimi është i njëjtë për të gjithë. Të gjithë duhet të ecim në të njëjtën rrugë dhe të besojmë në të.

Jetojmë në një kohë kur është shumë e rëndësishme të veçosh veten nga të tjerët. Ndonjëherë më duket se njerëzit madje kultivojnë dallimet e tyre për të treguar: "Jo, unë nuk jam si ju, ju duhet të më respektoni. Unë jam ndryshe." Edhe kjo është në rregull. Ne duhet të pranojmë dallimet në



fqinjnin tonë. Nuk duhet ta diskutojmë këtë. Por nuk duhet të jetë qëllimi ynë të theksojmë dhe të këmbëngulim në dallimet tona. Një bukë! Ne jemi një trup! Le të theksojmë atë që kemi të përbashkët në Krishtin! Dallimet tona nuk kanë rëndësi. E rëndësishme është që zgjidhja të jetë e njëjtë për të gjithë ne. Rruga që duhet të ndjekim është e njëjtë për të gjithë ne. Pra, le të ndalojmë së kultivuari dallimet tona. Po, ne respektojmë dallimet e njëri-tjetrit, por ju lutemi të përqendrohemi në atë që kemi të përbashkët.

Kur Jezusi themeloi Darkën e Shenjtë, fillimisht u dha dishepujve pak bukë. Pastaj mori një kupë verë, ia dha dishepullit të parë dhe i tha: "Pini të gjithë prej saj" (Mt 26:27). Ishte vetëm një kupë, kështu që i pari duhej t'i jepte kupën e verës të dytit, i dyti të tretit, e kështu me radhë; kështu kupa u rrotullua në grupin e dishepujve. Jezusi tha: "...ky është gjaku im i besëlidhjes së re, që derdhet për shumë njerëz, për faljen e mëkateve të tyre" (Mateu 26,28). Kjo është një tablo e bukur. Kjo kupë me verë, gjaku i Jezusit, qarkullon në rrethin e dishepujve ashtu si gjaku qarkullon në trup. Një gjak, një trup. Sigurisht, për arsye praktike, ne festojmë Darkën e Shenjtë sot me hostje që përmban verën; por kuptimi mbetet. Kur festojmë Darkën e Shenjtë, gjaku i Jezusit derdhet në kishë ku duhet të qarkullojë. Ne jemi të vetëdijshëm se të gjithë duhet të pastrohemi prej



Apostuli kryesor Schneider emëroi katër Apostuj të rinj për USA: Lonnie Klein, Mark Feuerbach, John Schnabel und Brett Steinbrueck (nga e majta në të djathtë)

gjakut të Jezu Krishtit, përndryshe nuk kemi çlirim, nuk kemi shpëtim. Ne kemi nevojë për faljen e mëkateve. Ne jemi plotësisht të varur prej tij. Çdo pjesë e trupit varet nga qarkullimi i gjakut. Pali tha: “Syri nuk mund t’i thotë dorës: Nuk kam nevojë për ty; Ose koka t’i thotë këmbëve, nuk kam nevojë për ju” (1 Korintasve 12,21). Kjo është një tabllë e bukur për bashkësinë, për kishën, për unitetin e kishës, unitetin e besimtarëve: ne të gjithë jemi plotësisht të varur nga gjaku i Jezu Krishtit. Kjo na ndihmon të jemi një dhe kjo është ajo që ne mund të përjetojmë ndërsa Fryma e Shenjtë vepron nëpërmjet apostulatit.

Pika e fundit në lidhje me Darkën e Shenjtë: kur e festojmë, është një parashijim i Darkës së madhe që do të festojmë në parajsë në bashkësi me Zotin tonë Jezu Krisht. Na kujton se të gjithë kemi të njëjtën të ardhme; dhe ajo e ardhme do të jetë gëzimi ynë. Sido që të jetë situata, ne kemi të njëjtin synim dhe kur festojmë Darkën e Shenjtë themi të gjithë së bashku: “Çfarëdo që të ndodhë, Ai do të vijë.” Kjo është bindja jonë. Njerëzit e tjerë dhe djalli mund të bëjnë çfarë të duan. Askush nuk mund ta pengojë Jezusin që të vijë përsëri, dhe pastaj ne duam të hyjmë në mbretërinë e tij së bashku me të.

Të dashur vëllezër dhe motrat e mia, “Së bashku në Krishtin” është motoja jonë për këtë vit. Qëllimi ynë është shoqëria e përjetshme me Të. Për këtë ne duhet të besojmë

në mësimet e apostujve siç është shkruar në Bibël. Ne e shohim Jezusin ashtu siç e kanë përshkruar atë apostujt e biblës. Për të pasur shoqëri me Jezusin, duhet të kemi shoqëri me njëri-tjetrin. Si shoqëria me Perëndinë, ashtu edhe shoqëria me njëri-tjetrin janë të mundshme, sepse ne marrim gjithçka që na nevojitet nëpërmjet punës së Frymës së Shenjtë, nëpërmjet apostujve të dërguar prej tij. Ky është thesari ynë. Ky është besimi ynë. Ne i jemi mirënjohës Atit tonë Qiellor për mëshirën e Tij!

MENDIME KYÇE.

Qëllimi ynë është bashkimi me Zotin. Për këtë, ne i qëndrojmë besnikë mësimet e apostujve dhe kontribuojmë në unitetin e besimtarëve. Marrja e Darkës së Shenjtë të gjithë së bashku forcon bashkimin tonë me Zotin dhe me njëri-tjetrin.

KAINI NUK E DËGJOI PERËNDINË

SIPAS ZAN. 4,1-16

Adami dhe Eva kanë dy djem. Djali i madh quhet Kain, i vogli Abel. Kaini është bujk, Abeli është bari.

Një ditë Kaini i sjell Perëndisë një flijim nga frytet e arës. Abeli gjithashtu i sjell Perëndisë kafshët e parëlindura të kopesë së tij

dhe dhjamin e tyre.

Zoti e shikon me kënaqësi Abelin dhe sakrificën e tij. Kaini zemërohet shumë për këtë.

Vështrimi i tij errësohet.


Zoti e pyet Kainin: “Pse je kaq i zemëruar? Dhe pse po i ul sytë përdhe? A nuk është kështu: nëse ke planifikuar diçka të mirë, mund t’i ngresh sytë lart. Por nëse nuk ke planifikuar diçka të mirë, mëkatin do ta kesh pas dere. Ai mezi po pret; mos u dorëzo para tij.”

Kaini i thotë vëllait të tij Abelit: “Le të shkojmë në fushë.” Dhe



kur shkuan atje, Kaini e vret vëllanë e tij.
 Zoti e pyet Kainin: „Ku është vëllai yt Abeli?“
 Ai përgjigjet: “Nuk e di. A duhet të jem unë rojtari i vëllait tim?”
 Zoti thotë: „Çfarë ke bërë? Gjaku i vëllait tënd më thërret nga toka. I mallkuar do jesh, po të punosh arën, por ajo nuk do të të japë më prodhime. Dhe nuk do të kesh më shtëpi, atdhe”.

Kaini i përgjigjet Zotit: „Dënimi është shumë i rëndë, nuk mund ta duroj. Ti po më ndjek nga fusha sot dhe unë duhet të fshihem prej teje. Nuk do të kem më shtëpi. Dhe kushdo që do më gjejë, do të më vrasë.”
 Por Zoti tregohet i mëshirshëm. Ai i jep Kainit një shenjë që askush të mos e dëmtojë: „Jo, nëse dikush të vret, hakmerrja do të jetë shtatëfish.“ Dhe Kaini largohet nga Zoti.



PËR VIZITË TEK AUBREY IN PALATINE (USA)

Unë quhem Aubrey, banoj në Palatine, një lagje para Chikagos, një qytet i madh në shtetin Illinois. Jam tetë vjeç.



Kam katër motra e vëllezër: Motra ime Mackenzie, është njëmbëdhjetë, vëllai im Colin pesë. Dy motrat e mia më të vogla Emerson dhe Mallory janë binjake, ato janë tre vjeçe. Nëna ime Britta është mësuese matematike dhe babai im Michael është IT-Projektmanager.

Këtu kam dale në fotografi në Chikago para skulpturës Cloud-Gate, të cilën shumë njerëz e quajnë me dashuri „Die Bohne“. Unë kam veshur një T-shirt në ngjyrë mente – mentja është ngjyra ime e preferuar!



Anëtarë të tjerë të familjes sime të madhe banojnë në rrethinat e Chikagos, ndër ta gjyshërit, teze, halla e xhaxhllarë apo daja.. Gjyshi im është mekanik, ai riparon autobuzat për shoqërinë e transportit urban CTA (Chicago Transit Authority).

Edhe pse banojmë pranë një qyteti të madh, shtëpia jonë është afër një parku nacional. Kur është kohë e mirë, ne ndërmarim shëtitje të gjata në të. Në atë



zone ka shumë kafshë si kaprollë, shqiponja, rosa, çafka dhe pata. Ndonjëherë ne shohim edhe kojotë. Veçanërisht interesante është që herë pas here ndonjë kafshë vjen edhe në kopshtin tonë.



Mackenzie, Colin dhe unë shkojmë në të njëjtën shkollë. Për një kohë të gjatë, për shkak të Pandemisë së Koronës na u desh të mësonim në shtëpi, porse tani na lejohej të shkojmë përsëri në shkollë.

Unë gëzoj pa masë që arrij t'i takoj të gjithë shokët e mi. Mbas mësimet marr pjesë në kursin e gjimnastikës ose luaj football. Kam katër vjet që merrem me gjimnastikë. Unë preferoj të bëj gjimnastikë në hekura paralele. Kam filluar futbollin vetëm një vit më parë dhe kam ende shumë për të mësuar, por shënova një gol në ndeshjen e fundit sezonin e kaluar!

Ne do të shkojmë në Hilton Head Island në Karolinën e Jugut për pushimet verore. Gjëja ime më e preferuar që bëj atje është të notoj në Atlantik me vëllezërit e motrat e mia. Më pëlqen gjithashtu të ha atje ushqime me fruta deti, veçanërisht midhje dhe karkaleca.



Për shkak të pandemisë së koronës, edhe kisha jonë duhej të qëndronte e mbyllur për një vit. Gjatë kësaj kohe, ne mundëm të ndiqnim nga shtëpitë tona nëpërmjet YouTube shërbesat e drejtuara nga apostujt tanë. Kam ndjekur orët e Shkollës të së Dielës në internet nëpërmjet Zoom. Ndërsa kisha ishte e mbyllur, një ndërtesë e re u ndërtua në Addison për bashkësinë tonë dhe tani është pothuajse e përfunduar. Ajo është shumë më e bukur dhe shumë më e madhe se e vjetra. Mezi pres që Apostuli ynë i Distriktit të përurojë kishën e re, në mënyrë që ne të mund të mbajmë orët e Shkollës të së Dielës atje.





Photo: Photographee.eu - stock.adobe.com

Midis eutanazisë (ndihmës gjatë procesit të vdekjes) dhe mjekësisë paliative

Mendimi se vdekja po afro është shpesh i frikshëm: vuajtje, vetmi, të qenit në mëshirën e të tjerëve. Shpejt lind dëshira për të vendosur vetë fundin e jetës – një ecje e ekuilibruar, për të cilën besimi i krishterë ofron një ndihmë orientuese.

Ndihma që jepet për një vetëvrasje shpesh përmendet në lidhje me eutanazinë, ndihmës për të vdekur. Në ndryshim nga eutanazia, pacienti shkon vetë drejt vdekjes. Ai mbështetet nga një person tjetër (ndihmës).

Legjislacioni për eutanazinë dhe vetëvrasjen e ndihmuar është specifik për vendin dhe shumë i ndryshëm. Debatet sociale kanë të bëjnë me legalizimin. Ligjet përkatëse të vendeve të ndryshme mund të gjenden në internet.

Ndihmë në vdekje

Në lidhje me afrimin e vdekjes, është e nevojshme të peshoni se cilat opsione mjekësore do të përdoren. Pacienti, mjekët dhe të afërmit do të sqarojnë se deri në çfarë mase duhet të lejohet ecuria natyrale e sëmundjes. Nëse pacienti nuk është më në gjendje të marrë vendimet vetë, shtrirja e trajtimit mund të vendoset në bazë të një dekreti, një shkrimi të pacientit që është sa më aktual. Nëse kjo nuk është e disponueshme, në varësi të legjislacionit, mjekët mund të marrin një vendim edhe në konsultim me të afërmit.

Qëllimi i terapisë nuk është më shërimi apo zgjatja e jetës. Fokusi është në zbutjen e simptomave të tilla si dhimbja ose gulçimi dhe shoqërimi i tyre. Synimi nuk është të sjellë vdekjen, por të lejojë rrjedhën natyrale të sëmundjes dhe vdekjes. Kjo përfshin heqjen dorë nga masat për zgjatjen e jetës (p.sh. ringjalljen, frymëmarrjen artificiale, ushqimin artificial, dializën), reduktimin e ilaçeve që zgjasin jetën ose mos vazhdimin e disa masave të caktuara. Nuk është e përshtatshme të përdoren të gjitha opsionet e terapisë. Të ushqyerit dhe lëngjet duhet të vazhdojnë për aq kohë ato ndihmojnë pa e shqetësuar personin që vdes.

Në këto raste, është e rëndësishme të përdoret kujdesi paliativ për të eliminuar ose lehtësuar simptomat shqetësuese si dhimbje, gulçim dhe ankth. Kujdesi infermieror dhe njerëzor është po aq i rëndësishëm në fund të jetës. Klinikat dhe shërbimet spitalore janë shumë të vlefshme këtu. Shoqërimi nga të afërmit dhe kujdestarët shpirtërorë është i theksuar në të gjitha kulturat dhe fetë.

Pavarësisht kujdesit mjekësor, infermieror, njerëzor dhe shpirtëror në fund të jetës, ndodhin megjithatë dhimbje të forta dhe frikë e shqetësimi i madh. Për të kontrolluar simptomat, mund të jetë e nevojshme, në konsultim me pacientin ose të afërmit, të përdoret një dozë e lartë e ilaçeve zbutëse dhe qetësuese. Efekti i tyre anësor mund të

jetë reduktimi i frymëmarrjes dhe, në raste të rralla, edhe shkurtimi i jetës.

Konsiderata etike

Një kërkesë e përbashkët është që dinjiteti njerëzor të ruhet edhe në vdekje. Ndërsa mbështetësit e eutanazisë aktive e shohin këtë të realizuar në të drejtën për një vdekje të vetëvendosur dhe për këtë arsye bëjnë thirrje për eutanazi dhe vetëvrasje të asistuar, argumenti kryesor për kundërshtarët e eutanazisë aktive është paprekshmëria e jetës njerëzore: askush nuk mund t'i japë fund jetës njerëzore.

Respektimi ose mosrespektimi i shprehjes së vullnetit të një personi, p.sh. nëpërmjet një autorizimi me shkrim, shihet si shembull i respektimit ose vënies në dyshim të dinjitetit njerëzor. Në disa shkrime, vetëvendosja barazohet me dinjitetin njerëzor.

Parandalimi i vuajtjes është një argument qendror i bërë nga mrojtësit e eutanazisë dhe vetëvrasjes së asistuar që duket e vështirë për t'u argumentuar.

Zbutja e vuajtjeve është një qëllim qendror i mjekësisë dhe etikës moderne. Vuajtja shpesh barazohet me dhimbjen. Por vuajtja është më shumë mishërimi i përvojave negative. Ajo që përjetohet si vuajtje e padurueshme varet në thelb nga qëndrimi i vetë personit.

Ndihma me vuajtjet që perceptohen si të padurueshme mund të jetë shfaqja e vuajtjes si një arsye për zhvillimin e të mirave më të larta si përvoja e jetës ose virtytet. Kjo jep perspektiva të reja. Atëherë jeta mund të ketë kuptim dhe të jetë e rëndësishme edhe me dëmtime të rënda ose paafësi të rënda. Kjo bën të mundur që ta shohësh dhe ta pranosh vdekjen si detyrën e fundit të madhe në jetë.

Një shqetësim i kundërshtarëve të eutanazisë është të zgjerohen edhe kushtet në të cilat duhet të lejohet eutanazia aktive (p.sh. e kufizuar për pacientët me sëmundje të pashërueshme) dhe grupi i njerëzve për të cilët duhet të lejohet (p.sh. vetëm të rriturit). Për shembull, vendet që e bënë të ligjshme eutanazinë aktive për të rriturit, duke iu nënshtruar disa kushteve, më vonë e bënë të ligjshme edhe për fëmijët.

Sipas të kuptuarit konvencional, një mjek ndihmon për të luftuar sëmundjet. Pacientët i besojnë atij për t'i ndihmuar

që ata të përmirësohen. Kur mjekëve u jepet leja për të vrarë në mënyrë aktive (vrasje sipas kërkesës), kjo lidhje e rëndësishme besimi mund të prishet rëndë. Organizatat profesionale mjekësore vënë në dukje rrezikun e kësaj humbjeje besimi. Megjithatë, përkrahësit e eutanazisë dhe vetëvrasjes së asistuar e shohin mbështetjen e mjekëve si një ndihmë për një vdekje të durueshme.

Të vdesësh me dinjitet

Diskutimi rreth eutanazisë është kryesisht i njëanshëm dhe ka të bëjë më shumë me çështjen nëse eutanazia dhe vetëvrasja e asistuar, d.m.th., ndihma për të vdekur, janë etike të justifikueshme dhe a duhet të lejohen ose të kërkohen me ligj.

Aspekti shumë më i rëndësishëm nga pikëpamja e krishterë, se si është e mundur ndihma gjatë vdekjes në formën e shoqërimit dhe lehtësimit të vuajtjeve, shpesh lihet në plan të dytë.

Ndoshta askush nuk dëshiron të jetë i vetmuar dhe i braktisur në fund të jetës dhe të ndihet i tepërt apo edhe në mëshirën e të tjerëve. Për të respektuar dinjitetin njerëzor, kërkohet kujdes dhe mbështetje e kujdesshme, e vëmendshme dhe e ndjeshme, veçanërisht në këtë fazë të jetës. Mjekësia paliative e kualifikuar dhe kujdesi e shoqërimi në fund të jetës mund të kontribuojnë në këtë.

Pikëpamjet e krishtera

Nga këndvështrimi i krishterë, jeta është dhënë nga Zoti. Qeniet njerëzore kanë të drejtën e dinjitetit për arsye të përkushtimit që Zoti ka për ta (imazhi i Zotit), pavarësisht nga aftësitë e tyre apo gjendja e tyre shëndetësore. Prandaj, vrasja sipas kërkesës, si vetëvrasja e asistuar, shkel urdhrin: "Mos vrisni".

Si një dhuratë nga Zoti, jeta nuk duhet të përfundojë në mënyrë arbitrare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se duhet të përdoren gjithashtu të gjitha opsionet e mundshme për zgjatjen e jetës. Nga pikëpamja e krishterë, nuk është mëkat nëse i sëmuri ose ai që vdes heqin dorë nga terapitë ose masat që zgjasin jetën ose nëse këto terapi dhe masa ndërpriten sepse të sëmurët rëndë "dëshirojnë të vdesin në paqe".

Duke ndjekur urdhëresën e dashurisë ndaj tjetrit u kërkohet anëtarëve të familjes, bashkësisë dhe kujdestarëve shpirtërorë që të kujdesen për të sëmurët rëndë dhe për ata

që po vdesin në mënyrë të tillë që të reduktohet frika për t'u ndjerë të braktisur dhe për të qenë në mëshirën e tjetrit në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë procesin e vdekjes. Me rëndësi të madhe për të sëmurët rëndë dhe ata që vdesin është mundësia e një kujdesi të madh, të dashur dhe të vëmendshëm nga të afërmit dhe stafi specialist i një mjedisi të këndshëm në shtëpi, në një klinikë ose në një pavjon të kujdesit paliativ.

Po aq e rëndësishme është njohuria se kujdesi paliativ në shumë raste mund ta bëjë të durueshme dhimbjet dhe vështirësitë në fund të jetës. Nuk duhet harruar se edhe rrethanat më të mira nuk e bëjnë gjithçka të lehtë. Procesi i vdekjes, vetë vdekja dhe humbja mbeten të dhimbshme për ata që vdesin dhe për ata që kanë përreth tyre.

Megjithatë, ne të krishterët mund të përjetojmë ngushëllim dhe forcë nga besimi te Zoti dhe shpresë në mbështetjen dhe afërsinë e tij, sidomos në situata të vështira. Njohuria e jetës sonë të përjetshme dhe e ardhmja jonë me Perëndinë mund të zvogëlojë frikën e lamtumirës.

Qëndrimi i Kishës Apostolike të Re


Gjithkush ka të drejtë të vdesë me dinjitet. Eutanazia dhe kujdesi paliativ kanë të bëjnë me personin që vdes, për të cilin nuk ka asnjë perspektivë për t'u kuruar apo përmirësuar. Nga pikëpamja e krishterë, kjo mund të jetë vetëm ndihmë gjatë procesit të vdekjes dhe kurrë ndihmë për të vdekur.

Vrasja sipas kërkesës, si dhe vetëvrasja e asistuar, shkel urdhrin "Mos vra".

Lejimi i vdekjes duke mos marrë masa për të zgatur jetën nuk bie ndesh me parimet e besimit të krishterë. Lehtësimi i dhimbjes ose qetësimi në procesin e vdekjes me qëllimin e kontrollit të simptomave mund të sjellë një rrezik të vogël të shkurtimit të jetës. Meqenëse këto masa synojnë ekskluzivisht kontrollin e simptomave, ato mund të miratohen.

Mjekësia paliative në shumë raste mund ta bëjë të durueshme dhimbjen dhe vështirësitë në fund të jetës. Të ushqyerit dhe lëngjet duhet të vazhdojnë për aq kohë sa të ndihmojnë pa e shqetësuar personin që vdes.

Në përputhje me imazhin e krishterë të njeriut, duhet pasur kujdes që të sëmurët rëndë dhe ata që po vdesin të marrin mbështetje të dashur, të matur dhe të kujdesshme



Photos: Trsakace; kuprevich - stock.adobe.com

nga të afërmit e tyre dhe nga specialistët në një mjedis të këndshëm.

Eshtë e rëndësishme që të vdekurit dhe ata që janë përreth tij të kenë kujdesin shpirtëror të bazuar në përmbajtjen e Ungjillit, i cili siguron mbështetje të vazhdueshme dhe të besueshme në një fazë të jetës në të cilën shumë gjëra po ndryshojnë. Mbështetja e kujdesit shpirtëror mund të zvogëlojë frikën dhe të mobilizojë forcën mendore dhe shpirtërore.

Vendimi për terapi në fund të jetës duhet të merret nga vetë personi në fjalë. Këtu ai mund të marrë këshillat e mjekëve dhe të afërmyve të tij. Nëse kjo nuk është më e mundur, vendimi duhet të merret nga të afërmit së bashku me mjekët kurues, ku vullneti i supozuar i personit në fjalë është i një rëndësie të veçantë. Prandaj, në shumë raste është e dobishme të kesh lënë me shkrim një autorizim që shpreh vullnetin e personit që po vdes.

Udhëzimet dhe ligjet që janë në fuqi duhet të respektohen, për sa kohë nuk bien ndesh me vlerat e krishtera.

Përmbledhje

Gjithkush ka të drejtë të vdesë me dinjitet.

Eutanazia dhe kujdesi paliativ kanë të bëjnë me ata që vdesin, për të cilët nuk ka asnjë perspektivë për shërim apo përmirësim të gjendjes së tyre. Nga pikëpamja e krishterë, kjo mund të jetë vetëm ndihmë gjatë vdekjes dhe kurrë ndihmë për të vdekur. Vrasja sipas kërkesës dhe vetëvrasja e asistuar refuzohen.

Lejimi i vdekjes duke hequr dorë nga masat e zgjatjes së jetës dhe lehtësimin e dhimbjes ose qetësimin në procesin e vdekjes për të kontrolluar simptomat me rrezikun e ulët të shkurtimit të jetës, nuk bien ndesh me parimet e besimit të krishterë.

Në sfondin e imazhit të krishterë të njeriut, kujdesi paliativ ka një rëndësi të madhe. Mbështetja e njerëzve të afërt dhe kujdesi shpirtëror në frymën e Ungjillit mund të zvogëlojë frikën dhe të mobilizojë forcën mendore dhe shpirtërore. Shkrimet e lëna për së gjalli mund të ndihmojnë në shoqërimin e procesit të vdekjes në atë mënyrë që ata dëshirojnë.

Masthead

Botuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Peter Johanning

!Ne ecim me ritmin tonë

Mbledhja e vjeshtës për apostujt e distrikteve përfundoi. Temat kryesore me të cilat ata u morën ishin Të kuptuarit e postit, e detyrës, pyetjet e autorësisë biblike dhe linja apo rregulla të reja udhëzuese, drejtuese për vëllezërit e administratës.



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider dhe apostujt e distrikteve në takimin e tyre

Photo: Peter Johannig

Çështjet e autorësisë janë të rëndësishme për shumë bashkësi të krishtera: A është shkruar vërtet nga Pali apo nga një prej dishepuve të tij, cili ka shkruar Ungjijtë dhe shumë pyetje të tjera lidhur me këto. Mbledhja e Apostujve të Distriktit thotë qartë se Kisha Apostolike e Re nuk duhet të jetë, të qëndrojë për një mosmarrëveshje midis autoritetit dhe shkencës.

“Është e rëndësishme për ne të theksojmë se Shkrimet janë të frymëzuara nga Fryma e Shenjtë. Përcaktuese nuk është çështja e autorit, pra se kush e ka shkruar, por përmbajtja e tekstit përkatës biblik. Çfarë thotë ai për shpëtimin tonë,

çlirim tonë” – kështu e nis fjalën e tij apostuli kryesor Jean-Luc Schneider për këtë pikë të rendit të ditës.

Autoriteti nuk është çështje autorësie

Pra, Perëndia është autori aktual i librave biblikë. Autoriteti i shkrimeve biblike bazohet në frymëzimin e tyre hyjnor dhe nuk varet nga autorët, nëse ata ishin apostuj dhe profetë apo jo. Në këtë aspekt, konstatimi ekzegjetik nëse një shkrim vjen nga ky apo ai autor apo jo, nuk ka asnjë rëndësi për autoritetin e këtij shkrimi. Autoriteti mësimdhënës i apostulatit nuk shërben për zgjidhjen e

problemeve individuale ekzegjetike. Përkundrazi, është dhënë për të siguruar pastërtinë e mësimave të Kishës dhe shpalljen e tyre.

Edhe Katekizmi është shprehur qartë për këtë çështje. Aty thuhet: «Autori i Shkrimeve të Shenjta është Perëndia dhe përpiluesit e tyre ishin njerëz të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë. Perëndia përdori aftësitë e tyre për të shkruar atë që Ai donte të transmetonte. Për sa i përket përmbajtjes, librat biblikë sigurojnë që e kanë origjinën në Frymën e Shenjtë, por për nga forma dhe mënyra e të shprehurit ato janë formësuar nga autorët përkatës dhe nga bota e tyre e ideve» (KNK 1.2).

Linja udhëzuese, drejtuese

Një libër i ri linjash, rregullash udhëzuese, drejtuese është duke u përfunduar. Ai përmban udhëzime të së drejtës kanonike të udhëheqjes, drejtimit të kishës dhe mënyrën se si do të kryhen, zbatohen detyrat dhe postet. Përveç komenteve bazë, do të ketë kapituj të detajuar mbi rregullat e posteve, të detyrave, lidhjes midis teksteve liturgjike, kremtimet apo festimet e shenjtërimeve dhe aktet e bekimit. Këtu përfshihen gjithashtu edhe shënime mbi kujdesin shpirtëror, ekumenizmin dhe marrëdhëniet me publikun.

Apostujt e Distriktit pranuan njëzëri të gjithë paketën dhe ngarkuan grupin e punës me redaktimin dhe përfundimin e mëposhtëm të botimit "Linja Udhëzuese për vëll. e admin."

Konsultime intensive dhe të kujdesshme

Pas një diskutimi të hollësishëm mbi temën e emërimit të grave me një post, me një detyrë shpirtërore, Apostujt e Distriktit mbështetën njëzëri propozimin procedural të Apostulit kryesor:

Kjo temë kërkon konsultim intensiv dhe të kujdesshëm. Nga këndvështrimi i Apostujve të Distriktit, nuk duhet të krijohet përshtypja se Kisha po e lejon këtë vetëm se vihet nën presionin e ndryshimeve shoqërore. Më parë, nuk kishte një përgjigje zyrtare teologjike për pyetjen nëse kishte arsye biblike kundër emërimit të grave. Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider e bëri qartë se baza për një diskutim të mëtejshëm është krijuar me dokumentin e publikuar së fundmi për barazinë e grave dhe burrave.

Ajo që vijon tani është një vështrim mbi kishën, traditat e saj, vlerat e saj. "Ne po marrim kohën tonë me diskutimet tona dhe do të publikojmë - sapo të jenë marrë të gjitha vendimet - një koncept thelbësor, ashtu siç bëme në 2019 me ndryshimin e Të kuptuarit e postit, e detyrës." Argumentet e atyre që mendojnë në mënyrë konservatore në këtë çështje, dhe frika se mos humbasin traditat e dashura duhet të merren po aq seriozisht sa dëshirat e të tjerëve që duan ndryshime dhe një ritëm më të shpejtë diskutimesh. "Ne ecim me ritmin tonë, marrim vendime për Kishën Apostolike të Re në tërësi, jo për njërin apo tjetrën palë", përmbledh diskutimin apostuli kryesor Schneider.

Të kuptuarit e kishës, shenjtërimit dhe detyrës

kryesor Richard Fehr filloi përgatitjet për krijimin e një katekizmi apostolik të ri në vitet 1990. Në atë kohë duhej vendosur se çfarë duhet të tregonte katekizmi për kishën e Jezu Krishtit, cili ishte kuptimi i tij.

Deri atëherë thuhej se Kisha Apostolike e Re ishte Kisha e Krishtit - kjo u rishikua dhe u ndryshua përmes konsultimeve të kujdesshme. Edhe pse kjo krijoi njëfarë trazire në shumë bashkësi, ishte thelbësore për t'iu qasur seriozisht dhe vërtetësisht një katekizmi. "U deshën vite," për këtë, përmbledhi shkurtimisht apostuli kryesor.

Vazhdimësi në ndryshim

Apostuli kryesor Wilhelm Leber promovoi krijimin e katekizmit dhe gjatë mandatit të tij iu përkushtua temës së madhe të Të kuptuarit të shenjtërimeve. E ashtuquajtura "Mbrëmja e Usterit" që ai moderoi më 24 janar 2006 është e paharrueshme: Pagëzimi në kisha të tjera u njoh dhe marrëdhënia midis pagëzimit dhe marrjes së vulës u ripërcaktua.

Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider i kushton shumë kohë dhe përpjekje çështjes së Të kuptuarit të postit, detyrës dhe çështjes që lidhet me emërimin e grave. Drejtuesi i Kishës thotë për këtë: "Duke trajtuar këtë temë, ne kuptuam se sa e gjerë dhe e thellë është ajo. Nuk mjafton të japësh një po të thjeshtë ose një jo të thjeshtë. Cilido qoftë rezultati i diskutimeve: Kjo temë është shumë e rëndësishme për ta trajtuar atë me nxitim dhe vetëm të lidhur me tendencat sociale."

Pasqyra

- 03.07.2022 Goma (RD Kongo)
- 07.07.2022 Limete Kinshasa (RD Kongo)
- 08.07.2022 Mbandaka (RD Kongo)
- 10.07.2022 Kinshasa (RD Kongo)
- 24.07.2022 Paide (Estoni)
- 27.07.2022 Bonaire (Antille)
- 30.07.2022 Paramaribo (Suriname)
- 02.08.2022 Kingston (Xhamajka)
- 04.08.2022 San Salvador (San Salvador)
- 07.08.2022 Mexiko (Meksikë)
- 14.08.2022 do të caktohet më vonë (Ukrainë)
- 11.09.2022 Freiburg (Zvicër)
- 18.09.2022 Iserlohn (Gjermani)
- 22.09.2022 do të caktohet më vonë (Gambia)
- 24.09.2022 do të caktohet më vonë (Senegal)
- 25.09.2022 do të caktohet më vonë (Guinea-Bissau)

New Apostolic Church
International

